

PROGRAM I CIKLIT TË PARË TË STUDIMIT

BACHELOR NË “MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR”

Emërtimi akademik i studimit	Diplomë Universitare Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me Vendim nr.04 , datë 10.01.2025
Cikli i studimit	Program i Ciklit të Parë të Studimit
Emri dhe statusi i institucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	3 (tre) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	a.Pranimi në këtë program studimi, është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe që plotëson kriterin e notës mesatare, të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. b. Në këtë program studimi, pranohen edhe ata kandidatë, të cilët kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë vendit, për të cilën kërkohet njëhësimi nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. c.Pranimi i studentëve për këtë program studimi kryhet nëpërmjet Maturës Shtetërore (portali U-albania). <i>Përlllogaritja 50% nota mesatare aritmetike e shkollës së mesme përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore dhe 50% gruplëndët e përcaktuara nga fakulteti për disiplinat bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihet lënda).</i>

Programi i studimit **Bachelor në“Mësuesi për Arsimin Fillor”**, ofron njohuri bazë mbi metodat e parimet shkencore të përgjithshme dhe aftësi specifike në fushën e mësuesisë për Arsimin Fillor. Organizohet në jo më pak se **180 kredite** dhe kohëzgjatja e tij është tre vite. Në përfundim lëshohet diplomë universitare **Bachelor në“Mësuesi për Arsimin Fillor”**. Studentët në programin e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.

Kërkesat gjithnjë e në rritje për përgatitjen e studentëve në shkollat e larta diktohen nga nevojat e progresit të shoqërisë në të gjitha fushat, nga zhvillimi i vrullshëm i shkencës, së arsimit dhe teknologjisë së mësimdhënies.

Qëllimi i këtij program është të thellojë njohuritë dhe shprehitë e marra nga të diplomuarit në ciklin e parë të formimit si mësues në**Arsimin Fillor**, duke i pajisur ata me dijet dhe shprehitë e nevojshme, shumëplanëshe dhe të shumëllojta, për të drejtuar me sukses procesin e mësimdhënies dhe të nxënit e nxënësve me qëllim që të jenë qytetarë aktivë të shoqërisë demokratike.

Nëpërmjet këtij programi ata do të pajisen me metodologji të reja sidomos në fushën e psikologjisë së zbatuar në mësimdhënie, në fushën e pedagogjisë dhe didaktikës si dhe do të thellojnë njohuritë e tyre në disiplina të ndryshme që lidhen me metodologjinë e arsimit fillor, në mënyrë që të kenë kompetencat pedagogjike të nevojshme për të organizuar dhe menaxhuar me sukses edukimin dhe vlerësimin e nxënësve.

Programi synon gjithashtu përgatitjen e specialistëve në fushën e edukimit, mësimdhënies, menaxhimit, organizimit dhe drejtimit të aplikueshme sidomos në **Arsimin Fillor**. Programi do të përgatitë specialist të cilët do të zbatojnë konceptin bashkëkohor për procesin e të nxënit duke i dhënë përparësi rolin aktiv të fëmijëvënë zhvillimin e njohurive të reja dhe të kompetencave si dhe ndryshimin e rolit të mësuesve që duhet të jenë, gjithnjë e më shumë, drejtues dhe krijues të situatave të të nxënit.

Ky program bëhet gjithashtu i nevojshëm nga shtrirja më e madhe kohore e arsimit fillor: nga 4 në 5 vjet, në përputhje me Ligjin për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Nr.69/2012. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë datë 31.07.2014. Kurrikula bërthamë për klasat parapërgatitore dhe arsimin fillor, 2014. Dispozitave normative, Arsimi Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, 2013

Ky program studimi synon që të diplomuarit në përfundim të ciklit të studimit:

- **Së pari**, të pajisen me aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe praktike që lidhen me fushën e edukimit në Arsimin Fillor.
- **Së dytit**, të pajisen me kompetenca të përgjithshme për jetë dhe punë si dhe të zhvillojnë edhe kompetencat e duhura për qasjen ndaj informacionit dhe përpunimin e tij në mënyrë të pavarur.
- **Së treti**, të aftësohen për të përzgjidhur atë çfarë është më e rëndësishme nga bota e madhe e informacionit, për të dalluar dijet e domosdoshme duke mbajtur një qëndrim kritik ndaj tyre.
- **Së katërti**, të pajisen me aftësi për të zgjidhur problemet dhe situatat praktike dhe me kompetenca të reja që i ndihmojnë të zotërojnë botën e sotme digjitale.
- **Së pesti**, të ndërtojnë dhe zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike.

- **Së gjashti**, të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake të shoqërisë shqiptare dhe të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.
- **Së shtati**, studentët që do të mbarojnë këtë program studimi, nuk do të fitojnë thjesht njohuri teorike tradicionale mbi këto fusha, por nga vetë struktura e planit mësimor dhe programeve të lëndëve mësimore të parashikuara në të, ata do të fitojnë më tepër njohuri dhe aftësi praktike bashkohore të domosdoshme për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të tregut tëpunës.
- **Së teti**, ky program studimi do të ndihmojë mjaft edhe për të rritur rolin e universitetit si një qendër e kërkimit shkencor dhe kualifikimit të gjithanshëm në Rajon.

VEPRIMTARITË FORMUESE

Lëndë të formimit të përgjithshëm: Hyrje në psikologji; Arsimi gjithëpërfshirës; Psikologji zhvillimi; Psikologji edukimi; Filozofi dhe sociologji edukimi; Studimi dhe shkrimi akademik; **Kredite: 34 ECTS**

Lëndë të formimit karakterizues: Matematikë; Matematikë 2 Gjuhë shqipe 1; Gjuhë shqipe 2; Art pamor dhe skenik; Letërsi për fëmijë; Edukim qytetar demokratik; Organizimi i shkollës; Njohuri për gjeografinë; Histori e Shqipërisë; Muzikë dhe kërcim; Edukim fizik dhe sporte; Shkencat e natyrës; Komunikim pedagogjik; Teori edukimi; Aftësim teknologjik; **Kredite: 90 ECTS**

Lëndë integruese: Pedagogji e edukimit familjar; Kujdesi për veten, siguria dhe shëndeti; Muzika në reduktimin e stresit; Histori e arsimit dhe mendimit pedagogjik; **Kredite: 26 ECTS**

Lëndë me zgjedhje: Shkrim dhe menaxhim projekti; E drejta për zhvillim; Psikologji sociale; Loja dhe edukimi në natyrë; **Kredite: 6 ECTS**

Lëndë të formimit plotësues: Gjuhë e huaj; TIK në edukim; Praktikë profesionale. **Kredite: 22 ECTS**

Provim i përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome: Tezë diplome ose provim përfundimtar **Kredite: 8 ECT**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm: 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	Deri në 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64 pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 - 84 pikë
9 (nëntë)	85 - 94 pikë
10 (dhjetë)	95 - 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Studentët që përfundojnë me sukses programin e **ciklit të parë Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”** fitojnë njohuri të thelluara teorike dhe praktike që u hapin rrugën për të vijuar studimet në ciklin e dytë. Ata kanë mundësi të ndjekin programe të ciklit të dytë të studimit Master në fusha si Mësimdhënia për Arsimin Fillor, Edukimi Gjithëpërfshirës, Psikologjia e Edukimit, Menaxhimi i Institucioneve Arsimore, Teknologjia në Edukim dhe disiplina të tjera të ngjashme. Gjithashtu, diploma e fituar u mundëson studentëve të aplikojnë në universitete brenda dhe jashtë vendit, falë përputhshmërisë me sistemin evropian të transferimit të krediteve (ECTS) dhe standardeve akademikendërkombëtare. Ky është program i akredituar në Republikën e Shqipërië.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Tregu i punës ka një kërkesë gjithnjë në rritje për mësues të përgatitur profesionalisht për ciklin fillor të arsimit bazë, të aftë të integrojnë njohuritë pedagogjike, psikologjike dhe didaktike në punën e tyre të përditshme me fëmijët e moshës 6–11 vjeç. Ky profil kërkon aftësi për të planifikuar dhe zbatuar një proces mësimor efektiv, për të ndërtuar mjedise të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, si dhe për të mbështetur zhvillimin akademik, social dhe emocional të çdo nxënësi. **Programi Bachelor në “Mësuesi për Arsimin Fillor”** synon të përgatisë profesionistë të kualifikuar që i përgjigjen standardeve bashkëkohore të arsimit dhe kërkesave të tregut të punës në shkollat publike dhe private të arsimit fillor, si edhe në institucione dhe projekte që mbështesin përfshirjen dhe cilësinë në edukim.

Të diplomuarit nga ky program mund të punësohen në:

1. **Shkolla publike** dhe private të arsimit bazë, si mësues të ciklit fillor (klasat I–V).
2. **Qendra edukative dhe komunitare** që ofrojnë mbështetje për fëmijët në fazën e hershme të shkollimit.
3. **Institucione dhe projekte** që promovojnë gjithëpërfshirjen dhe cilësinë në arsimin fillor.
4. **Organizata joqeveritare dhe struktura ndërkombëtare** që angazhohen në mbrojtjen dhe edukimin e fëmijëve.
5. **Spektori i trajnimit dhe zhvillimit profesional** për mësues të rinj dhe personel mbështetës në arsimin fillor.

Gjatë studimeve, studentët fitojnë njohuri dhe aftësi në:

- Planifikimin dhe realizimin e mësimdhënies sipas kurrikulës së arsimit fillor;
- Zhvillimin e metodave aktive dhe të përshtatura për të nxitur të nxënin gjithëpërfshirës;
- Mbështetjen e zhvillimit gjuhësor, logjik, krijues dhe social të fëmijëve të moshës 6–10 vjeç;
- Përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor dhe vlerësimin formues;
- Ndërtimin e një klime pozitive në klasë dhe menaxhimin e sjelljes së nxënësve;
- Bashkëpunimin efektiv me prindërit, kolegët dhe specialistët mbështetës;
- Zbatimin e parimeve të barazisë, etikës profesionale dhe mbrojtjes së fëmijëve në edukim.

Ky program përgatit mësues të arsimit fillor të aftë për të ndikuar pozitivisht në përvojën shkollore të fëmijëve dhe për të kontribuar në zhvillimin e një arsimi gjithëpërfshirës dhe cilësor, në përputhje me sfidat dhe prioritetet e shoqërisë bashkëkohore.

DETAJET E PROGRAMIT TËCIKLIT TË PARË TË STUDIMIT

BACHELOR NË “MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR”

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i parë				
1.	Hyrje në psikologji	6	150	1
2.	Matematikë 1	5	125	2
3.	Matematikë 2	5	125	1
4.	Gjuhë shqipe 1	9	225	1&2
5.	Gjuhë shqipe 2	6	150	1&2
6.	Art pamor dhe skenik	6	150	1
7.	Letërsi për fëmijë	6	150	2
8.	Pedagogji e edukimit familjar	5	125	1&2
9.	Gjuhë e huaj	8	200	2
10.	TIK në edukim	4	100	1
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Arsimi gjithëpërfshirës	6	150	1
2.	Psikologji Zhvillimi	6	150	1
3.	Psikologji Edukimi	6	150	2
4.	Edukim qytetar demokratik	6	150	1
5.	Organizimi i shkollës	6	150	1
6.	Histori e Shqipërisë	5	125	2
7.	Njohuri për Gjeografinë	5	125	2
8.	Muzikë dhe kërcim	6	150	1
9.	Edukim fizik dhe sporte	6	150	2
10.	Kujdesi për veten, siguria dhe shëndeti	4	100	2
Lëndë me zgjedhje				
13.	1.Shkrim dhe menaxhim projekti	4	100	2
	2. E drejta për zhvillim	4	100	2
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
Viti i tretë				
1.	Filozofi dhe sociologji edukimi	5	125	1
2.	Studim dhe shkrim akademik	5	125	1
3.	Shkencat e natyrës	6	150	2
4.	Komunikim pedagogjik	5	150	1
5.	Teori edukimi	4	100	2
6.	Aftësim teknologjik	5	125	1
7.	Muzika në reduktimin e stresit	5	125	1
8.	Histori e arsimit dhe Mendimit Pedagogjik	4	100	2
Lëndë me zgjedhje				
9.	1. Psikologji sociale	4	100	2
	2. Komunikimi pedagogjik	4	100	2
10.	Praktikë profesionale	10	250	1&2
11.	Detyrime përmbyllëse (tezë diplome/provim përfundimtar)	5	125	2
Gjithësej viti i tretë		60 ECTS	1500	
Gjithësej VITI I, II & III		180 ECTS	4500	

